



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN KRYESISHT ANËTARË TË KQV-VE PËR ZGJEDHJET PËR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratim të listave emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe propozimet e depozituara,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar, ka publikuar në gazeta dhe faqen e internetit njoftimin për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit të KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

KQZ, përmes njoftimit publik informoi shtetasit për kushtet për t'u emëruar anëtar i KQV-ve, në respektim të përcaktimeve të nenit 38 të Kodit Zgjedhor, dokumentacionin që duhej paraqitur dhe afatin e aplikimit.

Pas miratimit, nga KQZ, të vendimit nr.831 date 12.06.2019 të listës së shtetasve për anëtar kryesisht të KQV në Bashkinë Krujë, kanë shprehur interes sërish 21 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.



Nr. 864 i Vendimit

Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Cërrik, kanë shprehur interes 60 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

DPB ka kthyer përgjigje për rezultatet e verifikimit të gjendjes gjyqësore të shtetasve me vendbanim në bashkitë si më poshtë:

1. Bashkia Cërrik 60 shtetas
2. Bashkia Krujë 21 shtetas

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur verifikimit të të dhënave dhe verifikimit të gjendjes gjyqësore, rezulton se shtetasit që kanë shprehur interes për tu emëruar kryesisht anëtarë të KQV në tetë zonat zgjedhore si më sipër listuar, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.20, Bashkia Krujë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.46, Bashkia Cërrik, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 864 i Vendimit

Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019